

Media Content of today Friday, July 31, 2009

Summary

COMPANY MENTIONS.....	2
ENERGY NEWS.....	3

COMPANY MENTIONS¹

"Energy prices to increase in 2010" (Korrieri)

- As it was predicted, in 2010 Albanians will not be able to escape the energy price hike. Chairman of Energy Regulatory Agency (ERA) Bujar Nepravishta confirms that the request of CEZ Company for new energy prices will be made official in September. According to Nepravishta, ERA will review the request, and a decision will be made in December. While Nepravishta assures that for 2009 prices will not change, World Bank says that in 2010 energy prices are expected to be 10% higher. This increase is due to production cost and future energy purchases. According to World Bank representatives in Albania, if the government lifts the Value Added Tax then Albanians will not feel as much the burden of new energy prices. In April of this year, Czech company CEZ purchases the Albanian Energy Distribution System Operator. //

ENERGY NEWS²

"an increase in energy prices for 2010" (Panorama)

- Albanians should brace themselves for an increase in energy prices for 2010. In a meeting with the Albanian press, director of Energy Regulation Agency said that a series of factors influence this price hike, and if we expect a 24/7 energy supply then energy prices are going up. Energy prices in international markets and network losses are two of the main reasons behind this price hike. Another factor is that now Energy Distribution System Operator is a private company and has its own profit to look after. On the other hand, due to good weather conditions and the plentiful rains, domestic production will keep this price increase at a minimal. In September, Energy Regulation Agency will set the fees for transmitting and distribution, and also prices that consumers will have to pay for each KW of electricity.//

¹ Key wording: CEZ, OSSH, Jan Ivan, Petr Tomek, Novakova.

² Key wording: energji elektrike, shpërndarje, sistemi i shpërndarjes, sistemi i transmetimit, sistemi i prodhimit, KESH, hidrocentral, termocentral

COMPANY MENTIONS

MEDIA:	Korrieri	TYPE:	newspaper
DATE:	Saturday, July 04, 2009	FREQUENCY:	daily
PAGE:	11	REACH:	15317
HEADLINE:	"Energy prices to increase in 2010"		

- As it was predicted, in 2010 Albanians will not be able to escape the energy price hike. Chairman of Energy Regulatory Agency (ERA) Bujar Nepravishta confirms that the request of CEZ Company for new energy prices will be made official in September. According to Nepravishta, ERA will review the request, and a decision will be made in December. While Nepravishta assures that for 2009 prices will not change, World Bank says that in 2010 energy prices are expected to be 10% higher. This increase is due to production cost and future energy purchases. According to World Bank representatives in Albania, if the government lifts the Value Added Tax then Albanians will not feel as much the burden of new energy prices. In April of this year, Czech company CEZ purchases the Albanian Energy Distribution System Operator. //

"CEZ" propozon çmimet e reja, zyrtarizohen në shtator

Bujar Nepravishta konfirmon se kërkesa e kompanisë çeke që bleu Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, "CEZ", do të bëhet zyrtare në muajin shtator

Ashtu siç ishte parashikuar, shqiptarët nuk do t'i shpëtojnë rritjes së çmimit të energjisë elektrike për vitin që vjen. Megjithëse viti 2010 është parashikuar të jetë viti i rimëkëmbjes nga kriza botërore ekonomike, qytetarëve shqiptarë do t'u duhet të përballen me çmime më të larta se tani të energjisë. Kryetari i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), Bujar Nepravishta, konfirmon se kërkesa e kompanisë çeke që bleu Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, "CEZ", do të bëhet zyrtare në muajin shtator. Sipas tij, ERE do të shqyrtojë kërkesën dhe në muajt në vazhdim do të vendosë për çmimin e re të energjisë elektrike. "Në dhjetor të këtij viti do të merret një vendim në lidhje me çmimin e ndryshuar të energjisë elektrike, që do të aplikohet më pas në vitin 2010", u shpreh Nepravishta. Ndërkaq, sipas informacioneve zyrtare, "CEZ" në

mënyrë formale ka konsoliduar tashmë propozimet për çmimet e reja, që pritet të hyjnë në fuqi vitin që vjen. Kështu, një vit pasi çmimi i energjisë elektrike u rrit deri 70 për qind, te konsumatorët është kthyer frika për një rritje të re.

Çmimet

Ndërkaq, kryetari i ERE-së ka deklaruar më parë, se çmimi i energjisë elektrike për vitin 2009 do të mbetet i pandryshueshëm. Por sipas Bankës Botërore, çmimi i energjisë gjatë vitit 2010 mund të ketë rritje deri në mbi 10 për qind. Ndryshimi pritet nga kostot e prodhimit dhe blerjet e energjisë për vitin e ardhshëm. Përfaqësuesi i Bankës Botërore në Tiranë, Demetrios Papanasiou, i cili është përgjegjës për energjinë, është shprehur se do të ketë rritje të çmimit të energjisë. Sipas tij, konsumatorët mund të lehtësohen nga pagesat, nëse qeveria heq TVSH-në nga faturat e energjisë.

Privatizimi

Privatizimi final i OSSH-së te forma çeke "CEZ" u bë në prill të këtij viti. Sipas kontratës, ndër zhvillimet më të rëndësishme që do të vijnë nga privatizimi, është reduktimi i humbjeve. Aktualisht, e gjithë energjia që importohet mbulon humbjet, ndërkohë që "CEZ" ka marrë përsipër që të ulë me 17 për qind në 5 vjet humbjet. Ndër skenarët e parashikuar është që në total, çmimi i energjisë të rritet deri në 10 për qind, por kjo edhe mund

të mos ndodhë nëse qeveria ndërhyr me politikat e saj. Sipas vlerësimeve të BB-së, për çdo 5 lekë energji të paguar, një lek e merr shteti si taksë. Nëse do të ketë ndërhyrje në TVSH, atëherë tarifat mund të ulen, megjithëse mbetet një vendim politik, të cilin mund ta ndërmarrë vetëm qeveria. **B. Z.**



ENERGY NEWS

MEDIA:	Panorama	TYPE:	newspaper
DATE:	Friday, July 31, 2009	FREQUENCY:	daily
PAGE:	6	REACH:	154664
HEADLINE:	"an increase in energy prices for 2010"		

- Albanians should brace themselves for an increase in energy prices for 2010. In a meeting with the Albanian press, director of Energy Regulation Agency said that a series of factors influence this price hike, and if we expect a 24/7 energy supply then energy prices are going up. Energy prices in international markets and network losses are two of the main reasons behind this price hike. Another factor is that now Energy Distribution System Operator is a private company and has its own profit to look after. On the other hand, due to good weather conditions and the plentiful rains, domestic production will keep this price increase at a minimal. In September, Energy Regulation Agency will set the fees for transmitting and distribution, and also prices that consumers will have to pay for each KW of electricity.//

Enti Rregullator i Energjisë: Deri në fund të shtatorit do të marrin aplikimet për tarifën e reja

Në 2010 do të rritet çmimi i energjisë

Ja faktorët që do të ndikojnë në rritjen e çmimit të dritave

FABIOLA ÇELA

Vitin e ardhshëm faturat e energjisë elektrike do të jenë më të kripura. Ndryshe nga ky vit, në 2010-ën çmimi i energjisë elektrike do të pësojë rritje.

Ende nuk dihet se sa do të jetë masa e rritjes së çmimit të dritave, por kjo rritje pritet të jetë më e lartë se ajo e 2008-ës.

ÇMIMI

Në një prononcim për mediat, kreu i Entit Rregullator i Energjisë Elektrike, Bujar Nepravishta, tha se në rritjen e çmimit të energjisë ndikojnë një sërë faktorësh. Së pari, në momentin që do të ketë një furnizim me energji pa ndërprerje, atëherë edhe çmimi i saj do të jetë më i lartë.

"Sasia e importit dhe koinjunktura e tregut ndërkombëtar për importin e energjisë elektrike janë sërish një faktor që ndikojnë negativisht në çmimin e energjisë elektrike. Niveli i humbjeve, aktualisht tani, ndikon në

rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Faktor tjetër që ndikon janë investimet, duke qenë një subjekt privat OSSH do të ketë dhe një normë fitimi të caktuar, e cila natyrisht do të jetë në rendin normal, nuk mund të jetë pra, më e vogël se sa interesat bankare. Kështu që në këtë aspekt dhe kjo do të ndikojë. Nga ana tjetër, kushtet e mira hidrologjike, prodhimi i vendit ndikon në zvogëlimin e çmimit", shprehet ai. Deri në fund të muajit shtator Enti do të presë aplikimet për rritjen e çmimit, por këtë vit ndryshe nga vitet e tjera procedurat janë më të komplikuar. Kjo pasi sipas atij këtë vit do të përcaktohet çmimi i keq-gjenerimit, përcaktohet çmimi i furnizuesit publik me shumicë, i cili ia shet furnizuesit publik me pakicë që është OSSH-ja. Nga ana tjetër përcaktohen tarifën e transmetimit dhe të shpërndarjes dhe në fund përcaktohet dhe çmimi fundor i konsumatorëve. Në fakt

rritja e çmimit të energjisë është kërkuar shpesh herë edhe nga ndërkombëtarët. Por për këtë vit Qeveria vendosi që të mos ketë ndryshim të çmimit të energjisë elektrike. Tarifën ekzistuese të energjisë hynë në fuqi në mars të vitit 2008-ë. Sipas vendimit të marrë atë vit nga ERE, për familjarët që konsumojnë deri 300 kwh, çmimi i en-

ergjisë nuk pësoi rritje, tarifa për këtë kategori konsumatorësh vazhdoi të jetë 7 lekë/kwh. Sipas përlogaritjeve, gati 76 për qind e familjeve shqiptare konsumojnë deri në 300 kwh energji në muaj. Pjesa tjetër konsumojnë më

shumë se 300 kwh energji. Për këtë kategori familjesh që nuk e kursejnë energjinë çmimi është 12 lekë/kwh. Pra, për bandën deri në 300 kilovat rritja e çmimit ishte zero, ndërsa për bandën e dytë mbi 300 kwh rritja ishte 71.4 për qind. Për herë të parë që nga marsi i vitit të kaluar pagua-

jnë para edhe ata konsumatorë që nuk konsumojnë energji. Pra, nëse fatura mujore shënon "zero kwh" konsum, tarifa që do të paguhet është 200 lekë në muaj dhe kjo shumë paguhet për shërbimet që kryen OSSH si lexim i matësit, shpërndarja e

faturave etj., për sa i përket bizneseve, çmimi i energjisë nuk u rrit vetëm për furrat e bukës apo fabrikat e prodhimit të miellit. Në bazë të kontratës së shitjes, kompania çeke "Çez" ka dërdhur për llogari të qeverisë shqiptare në fund të transaksionit 102 milionë euro. Përsa i takon humbjeve, në kontratë është

parashikuar, që "ÇEZ" të ulë me 8 % humbjet në 2 vitet e para. Kompania çeke ka blerë aksionet e qeverisë shqiptare, çka do të thotë se nuk merr përsipër të mbulojë borxhet e akumuluarë për shkak të humbjeve apo edhe ndërhyrjeve në rrjet, apo si rezultat i mospagimit të faturave nga abonentët.

